



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 05.06.2013
Nr. 0204-295

PËR: Bajrush Ymeri, Kryetar i Komunës së Novobërdës
Shefkije Mehmeti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Novobërdës

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIM E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË NOVOBËRDËS NR. 02/511 të Pranuar me datë, 20.05.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit nr. 02/511 për dhënien në shfrytëzim të zyrës për nevoja të Bankës për Biznes nga Komuna e Novobërdës **KONSTATON** se:

- Vendimi nr. 02/511 është në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës" i cili ka përcaktuar procedurat e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër nga ana e organeve të Komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Novobërdës, që të ndërmarrin veprime konkrete, që Vendimi nr. 02/511 të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministërstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 05.06.2013
br. 0204-295

Za: Bajrush Ymeri, Gradonačelnik opštine Novo Brdo
Shefkije Mehmeti, Predsedavajući Skupštine opštine Novo Brdo

Predmet: Zahtev za ponovno razmatranje odluke opštine Novo Brdo
br. 02/511 primljeno dana , 20.05.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja zakonitosti odluke br. 02/511 za davanje na koristi kancelariju opštine Novo Brdo za potrebe banke za biznis **KONSTATUJE** da:

- Odluka br. 02/511 je u suprotnosti sa članom 5 zakona br.04/z-144 o davanju na koristi i razmeni nepokretnog opštinskog zemljišta " koja je odredila procedure o davanu na kratkoročno korišćenje nepokretne opštinske imovine od strane opštinskih organa.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave na osnovu člana 82 tačka 2 zakona o lokalnoj samoupravi *zahteva od strane Skupštine opštine /Gradonačelnika opštine Novo Brdo* , da preduzme konkretne mere stim da se odluka br. 02/511 uskladi sa zakonskim odredbama na snazi , u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocimna odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a

01-547
20.05.2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



pag

KUVENDI I KOMUNËS - SKUPSTINA OPŠTINE-MUNICIPAL ASSEMBLY

Në bazë të dispozitave të nenit 12.2 dhe nenit 14.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës nr.03/L-040 (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS - PRISHTINË VITI V / Nr. 72 - 25 QERSHOR 2010) dhe nenit 60.2 të Statutit të Komunës së Novobërdës, Kuvendi Komunal i Komunës së Novobërdës me datë 30.04.2013 merë këtë:

V E N D I M

- I. Me këtë vendim jepet në shfrytëzim zyra për nevoja të bankës në QSHQ të Bankës për Biznes.
- II. Afati kohor do të jetë prej 30.04.2013 - 30.04.2016.
- III. Banka si në pikën I të këtij vendimi nuk ka kurrfar obligimi ndaj Komunës për shkak ofrimit të nevojave të qytetarëve të Komunës Novobërdës.
- IV. Lokali ipet në shfrytëzim pa kompenzim të Qendra për Shërbim të Qytetarëve në objektin e Komunës.
- V. Për implementimin e vendimit si nën I, të këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
- VI. Vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Më 30.04.2013
Në Novobërdë

Shefkije Mehmieti
Kryesuese e Kuvendit

